



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
**REPUBLIKA KOSOVA**  
KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ



**KUVENDI I KOMUNËS SË PEJES**

**I.Numër:01-112/02-137812/21, datë: 22. Dhjetor 2021.**

Në bazë të nenit 11, nenit 12.2. pika d) dhe nenit 54 paragrafi 2 të Ligjit Nr.03/L – 040 Për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazetazyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28.datë: 04.qershor 2008”), dhe nenit 8 të Statutit të Komunës së Pejës, I.Numër:01-016/01-413431, dt.30 Shtator 2020, në propozim të kryetarit të komunës, Kuvendi i Komunës në takimin embajtur me datë: 22.Dhjetor 2021,merr:

**V E N D I M**

**Nr.05/2021**

**Mbi ndarjen - rezervimin e postit të Zavendëskryesuesit të kuvendit të komunës për komunitete**

1.**Z.Avdullah Dzešević**, përfaqësues i komunitetit joshumicë (komuniteti boshnjak) që ka marrë pjesë në zgjedhje me listen e hapur të kandidatëve për anëtarë të kuvendit të komunës së Pejës, me subjektin politik “IBJ”, e me qëllim të promovimit të të drejtave të komuniteteve joshumicë në komunë, **i ndahet–rezervohet posti i Zavendëskryesuesit për komunitete të Komunës së Pejës.**

2.Zavendëskryesuesi i kuvendit të komunës për komunitete, zgjidhet për mandat të njëjtë sikurse anëtarët e kuvendit të komunës.

3.Zëvendëskryesuesi i kuvendit të komunës për komunitete promovon dialog ndërkomunal dhe shërben si pikë qendrore zyrtare për adresimin e brengave dhe interesave të komuniteteve joshumicë në mbledhjet e kuvendit. Detyrat e zëvendëskryesuesit të kuvendit të komunës për komunitete përcaktohen me nenin 55 të LVL-së dhe dispozita tjera ligjore në fuqi.

4.Kompenzimi (paga mujore) është e përcaktuar me nenin 6 paragrafin 2 të Udhëzimit Administrativ Nr.16/2008 për pagesën e stafit politik në komuna të Qeverisë së Republikës së Kosovës, që përfshin deri në 40% të pagesës së kryetarit të Komunës.

5.Për Zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset kryetari i Komunës.

6.Ky vendim hynë në fuqi ditën e miratimit dhe do të publikohet në ueb faqen zyrtare të Komunës.

**Vendimi ti dërgohet:**

- 1x1. Kryetarit të Komunës.
- 1x1. Të emëruarit.
- 1x1. Zyrës së personelit.
- 1x1. DBF-ca
- 1x1. Arkivë.

